TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës Kosovës, Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, Ligjit nr. 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi nenit 4 pika 1,2,3,4 dhe 5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Vendimi nr.2902 të datës 12.11.2020, NPK."Trafiku Urban" SHA.-Prishtinë, më date 12.11.2020 shpall:

# K O N K U R S

**Pozitat e punës:** Dispeçer Linje – 3 punëtorë/e, prej tyre 2 punëtorë/e me aftësi të kufizuar;
**Orari i punës-** i plotë
**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit, me mundësi vazhdimi;

**Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Mban evidencën ditore të shoferëve dhe kondukterëve në harmoni me orarin ditor dhe mujor.
- Kujdeset mbi mirëmbajtjen e rregullave të nisjeve sipas orarit dhe siguron linjën e operimit.
- Në rast të mungesës së autobusëve të mjaftuar në linje , kontakton me dispeçerin e bazës dhe monitoruesin për ti ofruar ndihmë me autobus.
- Bënë nënshkrimin e urdhëresave të punës në fillim dhe mbarim të çdo turre , është përgjegjës për nënshkrimet e bëra në urdhëresë.
- I njëjti në shërbimin ekonomiko financiar furnizohet me bileta mujore sipas nr. serik dhe mban përgjegjësi me biletat e ngarkuara sipas nr. serik.
- Është i obliguar që me bileta mujore ti furnizoj pasagjerët sipas grup moshave-profesionit dhe çmimeve në to (nxënës, studentë, dhe punëtorë).
- Është i obliguar që nga pasagjerët të kërkoi dokumentacionin përkatës – fotografi, vërtetim etj.
- Është i obliguar që për çdo biletë të dhënë mujore të evidentoj pasagjerin në librin e posaçëm.
- Është i obliguar që për çdo ditë në arkën e ndërmarrjes – te arkëtari të dorëzoj pazarin ditorë për bileta të shitura .
- Kryen edhe punë të tjera me urdhër të Udhëheqësit të Transportit dhe Drejtorit të operatives.
- I raporton U.T.

**Kriteret dhe Dokumentacioni i kërkuar:**

- Shkolla e mesme apo fillore;
- Aplikacionin për punësim;
- Kopje të letërnjoftimit;
- Përvoja e punës përparësi;
- Dëshmi përkatëse që dëshmon se aplikuesi/ja është me aftësi të kufizuar (për aplikantët me aftësi të kufizuar)
- Etik profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

**Informata të përgjithshme:**

**Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com;

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html;

2. Dëshmi mbi shkollimi;

3. Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse posedon);

4. Kopja e letërnjoftimit;

5. Dëshmi përkatëse që dëshmon se aplikuesi/ja është me aftësi të kufizuar (për aplikantët me aftësi të kufizuar)

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

TrafikuUrban

- Forma e vlerësimit dhe procedurat e rekrutimit për personat me aftësi të kufizuar do të zhvillohen varësisht nga aftësia e kufizuar e aplikantit/es dhe mundësitë organizative të ndërmarrjes.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit : punesimi@trafikurban-pr.com.

Konkursi është i hapur nga data **13.11.2020** dhe përfundon më datë **27.11.2020** në ora 24:00.

Kryeshefi Ekzekutiv
Për: Lulzim Rexhepaj

N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. PRISHTINË